

## NJOFTIM PËR SHTYP

### **PËR DËRGIMIN NGA DHOMA E AVOKATISË TË LISTËS SË AVOKATËVE QË PLOTESOJNË KRITERET E PËRCAKTUARA LIGJORE PËR ANËTAR DHE ANËTAR ZËVENDËSUES NË KOMISIONIN E PAVARUR AD HOC PËR VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KLGJ DHE KLP NGA RRADHËT E AVOKATISË**

Pas kërkesës së Avokatit të Popullit, në kuadër të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraparak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 23 dhe 25 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në datën e sotme Dhoma e Avokatisë ka komunikuar listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore për anëtar dhe anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur Ad Hoc si më poshte:

1. Fatmir BRAKA
2. Maksim HAXHIA
3. Sokol PUTO
4. Arben VANI
5. Aurela ANASTASI
6. Genc ÇIFLIKU
7. Ardian LEKA
8. Aurela BOZO
9. Artan HAJDARI
10. Genti SINANI
11. Arben PRIFTI
12. Ardian VISHA
13. Irena RESO
14. Alban ÇAUSHI
15. Aranit ROSHI
16. Envi HICKA
17. Jordan DACI
18. Dorina HOXHA
19. Dritan JAHAJ
20. Ilir Dode

## 21. Erajd Dobjani

Në listën e dërguar nga Dhoma e Avokatisë gjenden dhe të dhëna të tjera personale që nuk mund të bëhen publike nga institucioni i Avokatit të Popullit për shkak të detyrimit për respektimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 123 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të listës së avokatëve për plotësimin e kritereve ligjore të parashikuara në nenin 19 të ligjit të sipërpërmendur, do të ftojë më të riun në moshë dhe më të vjetrin në moshë ndër ta që të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur Ad Hoc. Avokati i Popullit do të caktojë edhe 2 anëtarë zëvendësues, sipas së njëjtës procedurë dhe në bazë të të njëjtit kriter.

Pas përfundimit të këtij procesi, Avokati i Popullit do të bëjë publike emrat për anëtar dhe anëtar zëvendësues nga rradhët e avokatëve në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.